

## **Procedura e pajisjes me pasaportë biometrike të Republikës së Kosovës, sipas Udhëzimit Administrativ, nr.16/2011:**

### **Procedura e aplikimit për pasaportë për personat mbi moshën 16 vjeçare:**

- 1.1. Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Dëshminë për pagesën.

### **Procedura e aplikimit për pasaportë për personat nën moshën 16 vjeçare:**

1. Aplikuesi duhet të jetë prezent personalisht në QKRC, i shoqëruar nga të dy prindërit dhe duhet të paraqesë dokumentet si në vijim:
  - 1.1. Certifikatën e lindjes;
  - 1.2. Certifikatën e shtetësisë;
  - 1.3. Dëshminë për identitetin e prindërve (letërnjoftim, pasaportë ose patentë-shoferi);
  - 1.4. Nëse njëri prind është i vdekur, fëmija duhet të shoqërohet nga prindi tjetër, vdekja dëshmohet me certifikatën e vdekjes;
  - 1.5. Vendimi i gjykatës për përkujdesje ndaj fëmijës nëse prindërit janë të ndarë;
  - 1.6. Fëmija nën kujdestari duhet të shoqërohet nga kujdestari;
  - 1.7. Autorizimin origjinal dhe të vulosur nga noteri përkatësisht organi kompetent, nëse mungon njëri prind;
  - 1.8. Certifikata e vendbanimit;
  - 1.9. Dëshmia për pagesën.

### **Procedura e aplikimit për pasaportë të humbur/dëmtuar për personat mbi moshën 16 vjeçare**

- 1.1. Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Pasaportën e dëmtuar (nëse aplikon për pasaportë të dëmtuar);
- 1.3. Raportin policor origjinal nëse aplikon për humbjen e pasaportës, i cili duhet të jetë më i ri se tre muaj;
- 1.4. Dy fotografi të cilat duhet të jenë më të reja se tre muaj;

1.5. Dëshminë për shpalljen publike për humbjen e pasaportës;

1.6. Dëshminë për pagesën;

### **Procedura e aplikimit për pasaportë të humbur/dëmtuar për personat nën moshën 16 vjeçare:**

1.1. Aplikuesi i shoqëruar nga të dy prindërit duhet të paraqesë dokumentet si në vijim:

1.2. Dëshminë për identitetin e prindërve (letërnjoftim, pasaportë ose patentë-shoferë);

1.3 Nëse njëri prind është i vdekur, fëmija duhet të shoqërohet nga prindi tjetër-vdekja dëshmohet me certifikatën vdekjes;

1.4. Vendimi i gjykatës për përkujdesje ndaj fëmijës nëse prindërit janë të ndarë;

1.5. Fëmija nën kujdestari duhet të shoqërohet nga kujdestari;

1.6. Autorizimin origjinal dhe të vulosur nga noteri përkatësisht nga organi kompetent, nëse mungon njëri prind;

1.7. Raportin policor origjinal për humbjen e pasaportës i cili duhet të jetë më i ri se 3 muaj;

1.8. Dëshminë për shpalljen publike për humbjen e pasaportës;

1.9. Dëshminë për pagesën;

### **Procedura e aplikimit për ndërrimin e të dhënave në pasaportë për personat nën moshën 16 vjeçare**

Aplikuesi duhet të jetë prezent në QKRC i shoqëruar nga të dy prindërit dhe duhet të ketë këto dokumente:

1.1. Pasaporta;

1.2. Certifikata e lindjes;

1.3. Vendimi apo ndonjë dokument tjetër i ligjshëm për ndërrimin e të dhënave;

1.4. Dëshmia për identitetin e prindërve (letërnjoftimi, pasaporta ose patentë-shoferi);

1.5. Nëse njëri prind është i vdekur fëmija duhet të shoqërohet nga prindi tjetër-vdekja dëshmohet me certifikatën e vdekjes;

1.6. Vendimi i gjykatës për përkujdesje ndaj fëmijës nëse prindërit janë të ndarë;

1.7. Fëmija nën kujdestari duhet të shoqërohet nga kujdestari;

1.8. Autorizimi origjinal dhe i vulosur nga noteri përkatësisht nga organi kompetent, nëse mungon njëri prind;

1.9. Certifikata e vendbanimit (nëse ka ndërrim adrese);

1.10. Dëshmia për pagesën

### **Procedura e aplikimit për ndërrimin e të dhënave në pasaportë për personat mbi moshën 16 vjeçare**

1. Para se të bëhet aplikimi për ndërrimin e të dhënave në pasaportë, duhet bërë ndërrimi i të dhënave në letërnjoftim;

2.1. Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës;

2.2. Pasaportën;

2.3. Dëshminë për pagesën.

### **Procedura e aplikimit për ripërtëritjen e të dhënave në pasaportë për personat mbi moshën 16 vjeçare**

Procedura e aplikimit për ripërtëritjen e të dhënave në pasaportë, ka të bëjë me ripërtëritjen e fotografisë dhe gjurmëve të gishtërinjve, ndërrimin e pasaportës nëse i ka kaluar afati i vlefshmërisë.

Para se të bëhet aplikimi për ripërtëritjen e të dhënave në pasaportë, duhet bërë ripërtëritja e të dhënave në letërnjoftim.

1.1. Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës;

1.2. Pasaportën

1.3. Dëshminë për pagesën

### **Procedura e aplikimit për ripërtëritjen e dhënave në pasaportë për personat nën moshën 16 vjeçare**

Në procedurën e aplikimit për ripërtëritjen e të dhënave në pasaportë që ka të bëjë me ripërtëritjen e të dhënave biometrike (fotografia).

Fëmija duhet të jetë prezent në QKRC shoqëruar nga të dy prindërit dhe duhet të paraqesë dokumentet si në vijim

1.1. Pasaportën;

- 1.2. Certifikatën e lindjes;
- 1.3. Dëshminë për identitetin e prindërve (letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferë);
- 1.4. Nëse njëri prind është i vdekur, fëmija duhet të shoqërohet vetëm nga prindi tjetër-vdekja dëshmohet me certifikatë të vdekjes;
- 1.5. Vendimi i gjykatës për përkujdesje ndaj fëmijës nëse prindërit janë të ndarë;
- 1.6. Fëmija nën kujdestari duhet të shoqërohet nga kujdestari;
- 1.7. Autorizimin origjinal dhe të vulosur nga noteri përkatësisht nga organi kompetent, nëse mungon njëri prind;
- 1.8. Certifikata e vendbanimit (nëse ka ndërrim adrese) ;
- 1.9. Dëshmia për pagesën;

**M e rastin e skadimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës, duhet të zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ.**

1. Personat që posedojnë pasaportë të Republikës së Kosovës mund të aplikojnë për marrjen e pasaportës elektronike pavarësisht prej afatit të vlefshmërisë së tyre.
2. Personat që posedojnë pasaportë të Republikës së Kosovës, mund të aplikojnë për marrjen e pasaportës së re dymbëdhjetë (12) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë.
3. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni mund të aplikohet për marrjen e pasaportës së re në raste të veçanta jo më gjatë se (18) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës.
4. Në rastet kur pasaportës i janë plotësuar fletët për shënim zyrtar, duhet të zbatohet procedura e njëjtë si për aplikim për pasaportë të dëmtuar, përkatësisht duhet të plotësohet formulari HD.
5. Në rastin nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni pasaporta dorëzohet në QKRC për invalidim. Pasaporta e invaliduar i kthehet aplikuesit.

**Procedura e tërheqjes së pasaportës për personat nën moshën 16 vjeçare**

1. Tërheqja e pasaportës duhet të bëhet personalisht nga aplikuesi, i cili shoqërohet nga njëri prind, përkatësisht nga përfaqësuesi i tij ligjor;
2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, tërheqjen e pasaportës mund ta bëjë njëri prind pa prezencën e fëmijës, duke dëshmuar me dokumentet në vijim:

- 2.1. Letërnjoftimi i prindit;
- 2.2. Certifikata e lindjes e fëmijës;
- 2.3. Dëftesa e formularit të aplikimit për pasaportë (fëmijës).

### **Tërheqja e pasaportës për personat mbi moshën 16 vjeçare me autorizim**

1. Tërheqjen e pasaportës duhet ta bëjë aplikuesi personalisht;
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, tërheqja e pasaportës mund të bëhet me autorizim origjinal të vërtetuar nga noteri apo organi kompetent;
3. Me rastin e tërheqjes së pasaportës i autorizuari duhet të prezantoj dëshminë për aplikim, letërnjoftimin dhe të nënshkruhet në listën (regjistrin) e evidencave;
4. Për secilën pasaportë të tërhequr duhet autorizim i veçantë nga i autorizuar;.

### **Rastet për shqyrtim**

1. Rastet për shqyrtim nënkuptojnë të gjitha aplikimet të cilat nuk mund të procesohen në mënyrë të rregullt, si në vijim:
  - 1.1. Në rastet kur aplikuesi aplikon për pasaportë për herë të parë, në bazën e të dhënave ekziston me numër tjetër personal, apo është i pajisur me pasaportë me numër tjetër personal.
  - 1.2. Në rastet kur aplikuesi aplikon për ndërrim apo ripërtëritje të të dhënave në pasaportë, ku të dhënat në dokumentacionin mbështetës dhe të dhënat në bazë të të dhënave nuk përputhen dhe nuk ka mbështetje ligjore për këtë mospërputhshmëri, atëherë rastet i dërgohen komisionit i cili themelohet nga organi kompetent.